The best actress was selected Emma Stone after her performance at La La Land, while Casey Affleck was chosen the best actor with the movie “Manchester by the Sea”. The best animated film was chosen “Zootopia”. The ceremony this year was magnificent, and became even more interesting because it was hosted by Jimmy Kimmel.





MTV Awards

Ngjarja më e madhe kulturore e muzikës “MTV Awards” edhe këtë vit u përcoll me shumë vëmendje nga artdashësit. Rita Ora, ishte ylli i mbrëmjes që u përfol më së shumti. Ajo u prezantua me një mantel banje, kurse gjatë mbrëmjes u paraqit me fustane tjera duke u përshtatur me performancat e saj. Shawn Mendes u shpall këngëtari më i mirë, dhe kënga e tij “There’s Nothing Holding’ Me Back” u zgjodh këna më e mirë. Artistë të tjerë, si David Guetta, Ed Sheeran, Dua Lipa e Eminem u shpërblyen gjithashtu.

MTV Awards

Najveći kulturni događaj za muziku “MTV Awards” i ove godine je praćen sa veliko pažnjom od strane ljubitelja umetnosti. Rita Ora, je bila zvezda večeri o kojoj se najviše prepričavalo. Ona se predstavila u jednom baden mantelu dok se tokom večeri pojavila sa drugim haljinama prilagodivši se njenim performansama. Shawn Mendes je izabran kao najbolji pevač, i njegova pesma “There’s Nothing Holding’ Me Back” je izabrana kao najbolja pesma. Ostali umetnici kao David Guetta, Ed Sheeran, Dua Lipa i Eminem takođe su nagrađeni.

MTV Awards

The biggest music cultural event “MTV Awards” this year was followed with enormous attention from art lovers. Rita Ora, was the star of the night that everyone talked about. She was introduced with a bathrobe and during the evening she appeared with other dresses adapting her performances. Shawn Mendes was the winner as the best singer, and his song “There’s Nothing Holding ‘Me Back” was chosen the best song of the night. Other artists like David Guetta, Ed Sheeran, Dua Lipa and Eminem were also awarded.

Çmimi Nobel për Letërsi

Autori britanik Kazuo Ishiguro mori këtë vit Çmimin Nobel për Letërsi. Akademia suedeze e nderoi autorin me çmimin më të rëndësishëm për letërsi, pas vlerësimit të lartë që i bënë librave të tij "The Remains of the Day" dhe "Never Let me Go". Sipas akademisë suedeze librat e Ishiguros kanë një impakt të fortë emocional. Autori u shpreh të ketë qenë shumë i befasuar nga shpallja e tij fitues, ku për një moment kishte menduar që akademia gabimisht e kishte thënë emrin e tij.

Nobelova nagrada za književnost

Britanski autor Kazuo Išiguro je dobio ove godine Nobelovu Nagradu za Književnost. Švedska Akademija je nagradila autora sa najvažnijom nagradom za književnost nakon visoke ocene za njegove knjige "The Remains of the Day" i "Never Let me Go". Prema Švedskoj akademiji knjige Išigura imaju jedan snažni emocionalni uticaj. Autor je izazio veliko iznanađenje zbog njegovog izbora kao pobednika, gde je za trenutak pomislio da je akademija pogrešila kada je prozvala njegovo ime.

Nobel Prize for Literature

British author Kazuo Ishiguro received this year's Nobel Prize for Literature. The Swedish Academy honored him with the most important prize for literature after the high ratings his books "The Remains of the Day" and "Never Let Me Go" got. According to the Swedish Academy, Ishiguro's books have a strong emotional impact. The author said he was very surprised by the announcement, for a moment he thought the Academy made a mistake when they announced his name.





BAFTA

Edhe këtë vit u mbajt ceremonia e Akademisë Britanike e Filmit dhe Arteve Televizive (BAFTA). Në ceremoninë e mbajtur në shkurt, filmi që shtjellon temën e refugjatëve "Home", e që është një bashkë-produksion kosovaro-britanik, u shpall si më i miri në kategorinë Filmi i Shkurtër Britanik. Aktorja më e mirë u zgjodh Sarah Lancashire me perfomancën e saj në filmin "Happy Valley". Kurse aktori më i mirë Adeel Akhtar, me filmin "Murdered By My Father".

BAFTA

I ove godine je održana ceremonija Britanske Akademije Filma i Televizijske Umetnosti (BAFTA). Na ceremoniji održanoj u februaru film koji je razradio temu izbeglica "Home", i koji je jedna zajednička kosovsko-britanska produkcija, izabran je za najbolji film u kategoriji Kratkometražni Britanski Film. Najboljom glumicom je izabrana Sarah Lancashire sa njenom performansom u filmu "Happy Valley". Dok je najbolji glumac Adeel Akhtar sa filmom "Murdered By My Father".

BAFTA

The British Academy of Film and Television Arts (BAFTA) was held this February. Kosovar-British co-production movie "Home", that was about refugees, won in the category of short movies. The best actress was chosen Sarah Lancashire with her performance in "Happy Valley" movie. The best actor was chosen Adeel Akhtar with the movie "Murdered by My Father".

NGJARJET KULTURORE VENDORE

DOMAĆI KULTIRNI DOGAĐAJI

LOCAL CULTURAL EVENTS

Dokufest

Edhe këtë vit si çdo vit tjetër Dokufest u përcoll me vëmendje të veçantë e mblodhi shumë artdashës e turistë në Prizren. Kinematë e Dokufest u mbushën plot, derisa festivali edhe këtë vit u karakterizua me shumë ngjarje interesante kulturore. Në të u shfaqën 245 filma nga 63 shtete të botës. Filmi më i mirë i Ballkanit u zgjodh “Buffet željezara” nga Goran Dević. Edhe filma tjerë si “My life without air” dhe “69 minutes of 86 days” u shpërblyen me çmime.

Dokufest

I ove godine kao svake druge godine Dokufest je praćen sa posebnom pažnjom i sakupio je mnoge ljubitelje umetnosti i turista u Prizrene. Biskopi Dokufestu su bili puni, dok je festival i ove godine okarakterizovan mnogim interesantnim kultirnim događajima. Na njumu su prikazana 245 filma iz 63 država u svetu. Za najbolji Balkanski film je izabran “Buffet željezara” od Gorana Devića. I drugi filmovi kao “My life without air” i “69 minutes of 86 days” su dobili nagrade.

Dokufest

As every other year, Dokufest was followed with special attention, and brought together in Prizren many art lovers and tourists from around the world.
Dokufest’s cinemas were full, while the festival this year was characterized by many interesting cultural events. There were showed 245 films from 63 countries around the world. The best Balkan film was chosen “Ironworks Buffet” by Goran Dević. Other movies like “My life without air” and “69 minutes of 86 days” were awarded with prizes.



facebook.com/dokufestprizren/

PriFest

Prishtina edhe këtë vit u bë qytet i filmit, gjatë festivalit ndërkombëtar të filmit “PriFest”. Mysafir special i festivalit ishte regjisori Paul Heggis, fitues i shumë çmimeve Oscar. Këtë vit u shfaq filmi i metrazhit të mesëm “Tisa”, që shtjellon temën e viktimave që humbën jetën në lumin “Tisa”. Filmi “T’padashtun”, me skenar dhe regji të Edon Rizvanollit, pati premierën kosovare, pikërisht në mbrëmjen e hapjes së PriFest.

PriFest

Priština je i ove godine bila grad filma tokom međunarodnog festivala filma “PriFest”. Specijalni gost festivala je bio režiser Paul Heggis, dobitnik mnogih nagrada Oskar. Ove godine je prikazan film srednje metraže “Tisa”, koji razrađuje temu žrtava koji su izgubili živote na reci “Tisa”. Film “Nešoželjni”, sa scenarijom i režijom Edona Rizvanolija, imao je kosovsku premijeru, tačnije u večeri otvaranja u PriFest.

PriFest

Prishtina became the city of film this year, during the international PriFest film festival. The festival’s special guest was director Paul Heggis, the winner of many Oscar prizes. This year, “Tisa” movie that discusses the topic of the victims who lost their lives in Tisa River was screened. Also, “T’padashtun” movie from Edon Rizvanolli had the Kosovo premiere, at the opening night of PriFest.





Debuton filmi “Martesa” i Blerta Zeqirit

Filmi artistik i metrazhit të gjatë “Martesa” e regjisores Blerta Zeqiri, është publikuar këtë vit. Traileri u lansua më herët, kurse premiera e filmit u shfaq më 28 nëntor dhe do të jetë pjesë e garës zyrtare të Tallinn Film Festival në Estoni. Në këtë film shtjellohet dashuria nëpërmjet një trekëndëshi, me rolet e tyre luajnë aktorët: Adriana Matoshi, Alban Ukaj e Genc Salihu.

Debituje film “Ženidba” od Blerta Zećiri

Umetnički dugometražni film “Ženidba” režiserke Blerta Zećiri je objavljen ove godine. Triler je lansiran ranije dok je premijera predstavljena 28 novembra i biće deo službenog takmičenja u Talin Film Festivalu u Estoniji. U ovom filmu se razvija ljubav između jednog trougla, u njihovim ulogama igraju glumci: Adriana Matoši, Alban Ukaj i Genc Salihu.

Blerta Zeqiri’s movie “The Marriage” debuts

“Marriage” movie by Blerta Zeqiri was released this year. The trailer was launched earlier and the premiere revealed on 28th of November and will be part of the official Tallinn Film Festival in Estonia. In this film that explores love through a triangle, with the cast of actors such as Adriana Matoshi, Alban Ukaj and Genc Salihu.

Filmi “Një Muaj” i Zgjim Terziqit


Këtë vit filmi i shkurtër “Një Muaj” me skenar dhe regji nga Zgjim Terziqi dhe producent Agon Syla është pranuar në konkurrencën zyrtare të filmave të shkurtër International Cinema of Tomorrow Competition në festivalin e Kajros, ku do të garojë për çmimin “Filmi më i mirë i shkurtër” dhe për çmimin special të jurisë. “Një Muaj” është film i bazuar në ngjarje të vërtetë dhe flet për Anën, një 40 vjeçare e verbër, e pa martuar, e cila jeton sipas marrëveshjes së katër motrave të saj.

Film “Jedan Mesec” od Zdjima Terzićia

Ovaj kratki film “Jedan Mesec” sa scenarijom i režijom od Zdjima Terzićia i producentom Agon Syla je primljen u zvaničnoj konkurenciji kratkih filmova International Cinema of Tomorrow Competition na festivalu u Kajro gde će se takmičiti za nagradu “ Najbolji kratki film” i specijalnu nagradu žirija. “Jedan Mesec” je film zasnovan na istinitom događaju i govori o Ani, jedna slepa 40 godišnjakinja, neoženjena, koja živi prema sporazumu četiri njene sestre.

“One Month” movie by Zgjim Terziqi

“One Month” short movie directed by Zgjim Terziqi and produced by Agon Syla, has been accepted in in the official competition for the best short film and the special jury prize in the International Cinema of Tomorrow Competition. “One Month” is a film based on a real story and talks about Anna, a blind, unmarried 40-year-old who lives under the supervision of her four sisters.



FILMAT MË TË PREFERUAR PËR T'U SHIKUAR GJATË FESTAVE TË FUNDIVITIT


NAJOMILJENIJI FILMOVI ZA GLEDANJE TOKOM NOVOGODIŠNJIH PRAZNIKA

BEST MOVIES TO WATCH DURING THE HOLIDAYS

Festat e fundvitit, pushimet dhe koha e kaluar në shtëpi, kërkon edhe filma të mirë e interesantë. Filmat gjithmonë kanë përcjellë mbrëmjet e këndshme në shtëpi pranë familjes. Industria e filmit kujdeset që për fundvit të lansojë filma të veçantë me tema nga Krishtlindjet dhe Viti i Ri. Ata në fokus kanë gjithmonë familjen, dashurinë dhe momentet interesante e qesharake. Edhe pse çdo vit prezantohen filma të rinj, janë disa filma klasikë që edhe pse të vjetër, mbeten ende më të preferuarit.

Novogodišnji praznici , odmor i vreme provedeno kući zahteva i dobre i interesantne filmove. Filmovi su uvek pratili prijatne večeri u kući pored porodice. Industrija filma se stara da krajem godine lansira posebne filmove sa tematikom iz Božića i Nove Godine. Oni u fokusu uvek imaju porodicu, ljubav i interesantne smešne trenutke. Iako se svake godine predstavljaju novi filmovi, ima nekoliko klasičnih filmova iako stari ostaju još uvek među omiljenima.

End of the Year Holidays and the time spent at home, is a great time for some interesting movies. Films have always accompanied pleasant nights in the family. Film industry always launches very special movies during the Christmas and New Year. The topics usually are about love, family and funny and nice moments. Even though every year new movies are launched, there are some classic movies that are still among favorites.



Seria e filmave "Home Alone"

Filmat më të dashur gjatë festave të fundvitit sigurisht që janë ato të "Home Alone". Filmi i parë "Home Alone" u publikua më 1990, i dyti më 1992, i treti më 1997, i katërti më 2004, dhe i fundit më 2012. Filmat tregojnë përvojat e djaloshit që mbetet i vetëm në shtëpi, pikërisht për festat e fundvitit dhe dredhitë e tij qesharake për të mbrojtur shtëpinë. Filmi Home Alone 1 ishte shumë i suksesshëm. Ai mblodhi 476.7 milionë dollarë dhe u rendit si filmi numër 1 për 12 javë.

Serija filmova "Home Alone"

Najomiljeniji filmovi tokom novogodišnjih praznika sigurno su oni iz "Home Alone". Prvi film "Home Alone" je prikazan 1990, drugi 1992, treći 1997, i četvrti 2004, i zadnji 2012 godine. Filmovi prikazuju iskustva dečaka koji ostaje sam u kući, tačnije za novogodišnje praznika i njegove smešne podvale da bi sačuvao kuću. Filmi Home Alone 1 je bio veoma uspešan. On je sakupio 476.7 miliona dolara, i bio je poređan kao film broj 1, za 12 nedelja.

"Home Alone" Movies

One of the best movies to watch during end of year holidays is for sure "Home Alone" movie series. The first movie was launched in 1990, the second one in 1992, the third one in 1997, the fourth in 2004 and the last one in 2012. Movies show the experiences of a young boy that is left home alone for Christmas. Movie presents his funny moments while he tries to save his home. Home Alone 1 movie was very successful. It was able to get 476.7 million dollars in revenue and was ranked number one movie for 12 weeks.

Dr. Seuss' How the Grinch Stole Christmas

Ky film tregon historinë e Grinchit, karakterit të gjelbër që urren Krishtlindjet dhe që dëshiron t'i shkatërrojë ato në fshatin e Whoville. Filmi i prodhuar në vitin 2000 nga Ron Howard, u adaptua nga libri i Dr. Seuss. Për shkak të momenteve qesharake dhe interesante, filmi ende pëlqehet nga publiku, duke vazhduar të jetë një film klasik i festave të fundvitit.

"Dr. Seuss' How the Grinch Stole Christmas"

Ovaj film prikazuje istoriju Grincha, zeleni karakter koji mrzi Božić i želi da uništi to u selu Whoville. Film je proizveden 2000 godine od Ron Howard, prilagođen iz knjige Dr. Seuss. Zbog smešnih i interesantnih trenutaka film je još uvek omiljen među gledaocima, nastavljajući da bude jedan klasičan film novogodišnjih praznika.

Dr. Seuss' How the Grinch Stole Christmas

This movie presents the history of Grinch, a green character that hates Christmas, and wants to ruin them in Whoville village. This movie was produced in 2000 from Ron Howard, and was adapted from the renowned Dr. Seuss book series. Because of many funny and interesting moments, this movie is still a favorite, being a classic holiday movie.





The Santa Clause

Filmi "The Santa Clause" është film i prodhuar në vitin 1994, me regji të John Pasquin. Tregon historinë e Scott Calvin një njeriu të thjeshtë që aksidentalisht e rrëzon babagjyshin nga çatia e shtëpisë, dhe me magji shndërrohet vetë në babagjysh. Babagjyshit të ri i rritet mjekra dhe i shëndoshet barku. Duke hasur në situata interesante dhe komike, karakteri bëhet i dashur për të gjithë. Edhe pse i vjetër, ky film mbetet klasik i festave të fundvitit dhe ende shikohet nga miliona njerëz në tërë botën.

"The Santa Clause"

Film "The Santa Clause" je film proizveden 1994 godine, u režiji John Pasquin. Prikazuje istoriju Scott Calvin jednog čoveka koji nesrećno obara Deda Mraza sa krova, i sa magijom se sam pretvara u Deda Mraza. Novom Deda Mrazu izraste brada i povećava stomak. Susreće se u interesantnim i komičnim situacijama, karakter postaje omiljen za sve. Iako star ovaj film ostaje klasika novogodišnjih praznika i još se gleda od miliona ljudi širom sveta.

"The Santa Clause"

"The Santa Clause" movie is produced in 1994, directed by John Pasquin. It shows the story of Scott Calvin, an ordinary man who accidentally kills a man in a Santa suit, and then is magically transformed into a Santa. The new Santa Clause gains weight and grows an inexplicably white beard. By facing many comic situations, he becomes a really loving character in the movie. Even though this movie is quite old, it is still watched from millions of people around the world.

Elf

Filmi “Elf” një komedi familjare, prodhuar në vitin 2003, tregon historinë e një njeriu që është rritur si Elf dhe që vjen prej Polit të Veriut në Amerikë, në kërkim të identitetit të tij të vërtetë. Meqë është rritur si Elf, ai nuk mund të përshtatet me jetën në New York dhe e ka vështirësi në kërkim të babait të tij. Ky film ju bënë të qeshni fort dhe të relaksoheni derisa kaloni ditët e pushimit me familjet tuaja për fundvit.

“Elf”

Film “Elf” je porodična komedja, proizveden 2003 godine, prikazuje istoriju jednog čoveka koji je odrastao kao Elf i dolazi sa Severnog Pola u Americi, u potrazi sa njegovim pravim identitetom. Pošto je odrastao kao Elf, on se ne može prilagoditi sa životom u New Jorku i ima poteškoće u potrazi njegovog oca. Ovaj film će vas nasmejati jako i da se relaksirate dok provodite dane odmora sa vašom porodicom tokom novogodišnjih praznika.

“Elf”

“Elf” is a 2003 American Christmas fantasy comedy film directed by Jon Favreau and written by David Berenbaum. It shows the history of a man grown up as an Elf that comes from ne North Pole to America, in search of his true identity. Because he is grown up as an Elf he doesn’t fit in in the life of New York and has difficulties finding his father. This movie is very funny and gives you lots of laughs, while you enjoy your holiday with the family.





Jingle All The Way

Filmi “Jingle All The Way” u prodhua në vitin 1996 dhe është një film komedi, klasik i festave të fundvitit. Babai që luhet nga aktori i famshëm Arnold Schwarzenegger, bënë çmos që për Krishtlindje t’ia blejë djalit të tij dhuratën e preferuar. Mirëpo, në çdo dyqan lodra është shitur dhe ai duhet të udhëtojë në gjithë qytetin që të gjejë një të tillë. Filmi karakterizohet nga situata komike dhe interesante, që e bënë atë një film ideal për t’u shikuar gjatë festave të fundvitit.

“Jingle All The Way”

Film Jingle All The Way je proizveden 1996 godine i to je jedna klasična komedija novogošinjih praznika. Oca koga igra poznati glumac Arnold Schwarzenegger, čini svašta da za Božić kupi njegovom sinu omiljeni poklon. Ali u svakoj prodavnici igračka je prodata i on mora da putuje po celom gradu da bi pronašao jednu sličnu. Film karakterizuju komične i interesantne situacije, koje čine da film bude idealan za gledanje tokom novogodišnjih praznika.

“Jingle All The Way”

“Jingle All The Way” was produced in 1996 and is an American comedy film. The father, Arnold Schwarzenegger, vows to get his son a Turbo Man action figure for Christmas. Every store is sold out of them and he travels all over town and competes with everybody else in order to find one. This movie has many comic and interesting situation, that makes it a perfect one to watched during holidays.

KËNGËT E PREFERUARA GJATË FESTAVE TË FUNDVITIT

OMILJENE PESME TOKOM NOVOGODIŠNJIH PRAZNIKA

BEST END OF THE YEAR HOLIDAY SONGS

Secili meriton një atmosferë të këndshme tash kur festat e fundvitit po afrohen. E si do të ishte një festë e këndshme pa muzikë të mirë? Ndër vite kanë dominuar disa këngë që janë pëlqyer më së shumti nga publiku. Disa këngë edhe pse të vjetra, vazhdojnë të jenë të preferuara.

Svako zaslužuje jednu prijatnu atmosferu sada kada se približavaju novogodišnji praznici. Kako bi bio jedan prijatan praznik bez najbolje muzike? Godinama su dominirale neke pesme koje su se najviše sviđale publici. Neke pesme, iako su stare nastavljaju da budu omiljene.

Everyone deserves a nice celebration feeling, now that the holidays are just around the corner. And how can a celebration be complete without good music? Throughout years, many holiday theme songs have been published. Some of them are really liked from the public, even though they are old.



Maria Carey – “All I want for Christmas is you”

Në vitin 1994, Mariah Carey, krijoi këngën origjinale të Krishtlindjeve “All I want for Christmas is you”, që zuri numrin 83 në top-lista, mirëpo u ribë çdo vit, për çdo Krishtlindje derisa u bë një këngë klasike e festave. Tash, për të gjithë, kjo këngë mbetet më e preferuara.

Maria Carey – “All I want for Christmas is you”

Godine 1994, Mariah Carey je kreirala originalnu Božićnu “All I want for Christmas is you”, koja je zauzela 83 mesto u top listama, ali je svake godine prerađena, za svaki Božić dok nije postala jedna klasična praznična pesma. Sada za sve ova pesma ostaje najomiljenija.

Maria Carey – “All I want for Christmas is you”

In 1994, Mariah Carey wrote an original Christmas song called “All I Want For Christmas Is You.” It clipped the charts at number 83, but was revived for Christmas playlists year after year, until it became a holiday classic. Now, for most people this song is still one of the favorites.

Glee – “Jingle Bell Rock”

Nuk ka festë pa “Jingle Bell Rock”. Kënga e vetme rock e famshme e festave të fundvitit argëton ende miliona njerëz në çdo vend të botës. Kënga u publikua dy ditë para Krishtlindjeve në vitin 1957 nga Bobbly Helms dhe ende arrin të jetë në top listat e këngëve më të dashura. Ndër vite, kjo këngë u këndua nga shumë këngëtarë të famshëm dhe u bë kolona zanore e shumë filmave dhe programeve të njohur.


Glee – “Jingle Bell Rock”

Nema praznika bez “Jingle Bell Rock”. Jedina poznata rock pesma za novogodišnje praznike još uvek zabavlja milione ljudi na svakom mestu sveta. Pesma je objavljena dva dana pre Božića 1957 godine od Bobbly Helms i dalje uspeva da bude u top listama najomiljenijih pesama. Godinama su ovu pesmu otpevali mnogi slavni pevači i postala je zvučna kolona mnogih filmova i poznatih programa.

Glee – “Jingle Bell Rock”

There is no celebration without “Jingle Bell Rock”. The only famous rock song of holiday still entertains millions of people all around the world. This song was published two days before Christmas in 1957 by Bobby Helm and still is on the top list of most favorite songs.





Dean Martin - “Let it snow! Let it snow! Let it snow!”

Kënga “Let it snow! Let it snow! Let it snow!”, është krijuar në vitin 1945 nga Sammy Cahn dhe Jule Styne. Më vonë kënga është kënduar nga shumë këngëtarë të famshëm, si Frank Sinatra dhe Michael Bublé. Kënga jep mesazhin për të festuar me më të dashurit në shtëpi pranë stufës me zjarr, derisa jashtë bie borë. Edhe pse më shumë se 70 vjet, kjo këngë mbetet një nga klasiket e përhershme të festave.

Dean Martin - “Let it snow! Let it snow! Let it snow!”

Pesma “Let it snow! Let it snow! Let it snow!”, je nastala 1945 godine od Sammy Cahn i Jule Styne. Kasnije je pesma otpevana od mnogih slavnih pevača kao Frank Sinatra i Michael Bublé. Pesma šalje poruku da slavimo sa najvoljenijima u kući pored kamina dok napolju pada sneg. Iako ima više od 70 godina, ova pesma ostaje jedna od večite klasike praznika.

Dean Martin - “Let it snow! Let it snow! Let it snow!”

Let it snow! Let it snow! Let it snow!”, song was written by the songwriter Sammy Cahn and songwriter Jule Styne in 1945. Later the same song was covered by Frank Sinatra and Michael Buble. The song gives the message about making the most of a snowy day by spending it with loved ones by the fire.

Michael Bublé - “It’s Beginning to Look a Lot Like Christmas”

Lista nuk do të kompletohej pa zërin e Michael Bublé dhe këngën klasike kushtuar festave të fundvitit, me një melodi të lehtë e të ngrohtë. Kënga “It’s Beginning to Look a Lot like Christmas” është shkruar nga Meredith Willson, dhe është kënduar nga shumë këngëtarë të tjerë. Kënga ka qenë gjithashtu kolona zanore e filmit “Home Alone”.

Michael Bublé - “It’s Beginning to Look a Lot Like Christmas”

Lista ne bi bila kompletna bez glasa Michael Bublé, i klasične pesme posvećene novogodišnjim praznicima, sa jednom lakom i toplom melodijom. Pesma “It’s Beginning to Look a Lot like Christmas” je napisana od Meredith Willson, i otpevana od mnogo ostalih pevača. Pesma takođe bila zvučna kolona filma “Home Alone”.

Michael Bublé - “It’s Beginning to Look a Lot Like Christmas”

The list cannot be complete without Michael Buble’s voice, and his classic holiday song, with a nice and warm melody. “It’s Beginning to Look a Lot like Christmas” was written by Meredith Wilson, and during the years it has been sang by many singers. “It’s Beginning to Look a Lot Like Christmas” was official song of “Home Alone” movie.





Justin Bieber – “Mistletoe”

Lista mbyllet me këngën më të re të preferuar të fundvitit nga Justin Bieber. Këngëtari i ri lansoi këngën “Mistletoe” më 2011 gjatë një koncerti në Rio de Janeiro dhe arriti të marrë më shumë se 287 milionë klikime në kanalin e tij në Youtube. Kënga përçon mesazhin e dashurisë dhe mirësisë.

Justin Bieber – “Mistletoe”

Lista se zatvara najnovijom omiljenom novogodišnjom pesmom od Justin Bieber. Mladi pevač je lansirao pesmu “Mistletoe” 2011 godine tokom jednog koncerta u Rio de Janeiro i uspeo da dobije više od 287 miliona klikova na svom kanalu u Youtube. Pesma šalje poruku ljubavi i dobrote.

Justin Bieber – “Mistletoe”

Last but not least, “Mistletoe” by Justin Bieber is another favorite song. Bieber debuted the song in 2011 during a concert in Rio de Janeiro and reached more than 287 million clicks on his YouTube channel. This song transmits the message of love and friendship.

FITUESIT E ÇMIMIT NOBEL NË SHKENCË

DOBITNICI NOBELOVE NAGRADE ZA NAUKU

NOBEL PRIZE WINNERS IN SCIENCE

Çmimi Nobel për kimi

Shkencëtarët Jacques Dubochet, Joachim Frank dhe Richard Henderson, e kanë fituar Çmimin Nobel për kimi, për zhvillimin e mikroskopisë së krio-elektronit. Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave ka thënë se e ashtuquajtura "metodë e ftohtë" e zbuluar nga këta tre shkencëtarë, mundëson përcaktimin e strukturës së bio-molekulave në rezolucion të lartë.

"Kjo metodë e ka lëvizur biokiminë në një epokë të re", thuhet në arsyetimin me rastin e shpalljes së fituesve të çmimit, çmim ky në vlerë prej 1.1 milionë dollar amerikanë.

"Shkencëtarët tash mund t'i ngrijnë bio-molekulat dhe t'i vizuelizojnë proceset, që kurrë nuk janë parë më herët, dhe kjo është vendimtare për kuptimin bazik të kimisë së jetës dhe për zhvillimin e mjeteve farmaceutike", kanë thënë në Akademinë Mbretërore Suedeze të Shkencave në Stokholm. Shkencëtari Dubochet është zviceran, Frank është shtetas amerikan i lindur në Gjermani, ndërsa Henderson është britanik.

Nobelova nagrada za Hemiju

Naučnici Jacques Dubochet, Joachim Frank i Richard Henderson, dobitnici su Nobelove Nagrade za hemiju, za razvoj mikroskopije krio-elektrona. Švedska Kraljevska Akademija Nauka je rekla da je takozvana " hladna metoda" otkrivena od ova tri naučnika omogućava određivanje biomolekulne strukture u visokoj rezoluciji.

"Ova metoda je pomerila biohemiju u jednu novu epohu", kaže se u obrazloženju slučajem proglašenja dobitnika nagrade, u iznosu od 1.1 miliona američkih dolara.


"Naučnici sada mogu da smrzavaju biomolekule i da vizueliraju procese, koje nisu nikada viđene ranije, i ovo je odlučujeće za osnovno razumevanje hemije života i za razvoj farmaceutičkih sredstava", rekla je Švedska Kraljevska Akademija Nauka u Stokholmu. Naučnik Dubochet je švajcarac, Frank je američki državljanin rođen u Nemačkoj, dok je Henderson britanac.

Nobel Prize in Chemistry

Scientists Jacques Dubochet, Joachim Frank, and Richard Henderson have won the Nobel Prize for chemistry, for developing cryo-electron microscopy. Royal Swedish Academy of Sciences said that the so called "cold method" invented by the three scientist gives a high-resolution structure determination of biomolecules.

This method has moved biochemistry in new level" was said in the announcement of the prize winners. Prize worth 1.1 million American dollars.

"Researches can now freeze the biomolecules and visualize the processes that they have never seen before and this is crucial for understanding life chemistry and development of pharmaceuticals" said Royal Swedish Academy of Sciences in Stockholm.
Scientist Dubochet is Swiss, Frank is an American citizen born in Germany, while Henderson is British.





Çmimi Nobel në fizikë


Rainer Weiss, Barry C Barish dhe Kip S Thorne u shpallën fitues të Çmimit Nobel në fizikë për vitin 2017. Ata zhvilluan detektorin LIGO dhe arritën të observojnë valët gravitacionale. Shkencëtarët janë nderuar për punën e tyre në zhvillimin e Ligo-s (pajisje e posaçme e dizajnuar për observim dhe zbulim të valëve gravitacionale). "Çmimi i këtij viti tronditi botën", kanë thanë në Akademinë Mbretërore Suedeze të Shkencave në Stokholm. Prej këtyre observatorëve të sofistikuar në Tokë, shkencëtarët regjistruan valët gravitacionale nga përplasja e vrimave të zeza masive disa miliarda vite dritë larg.


Nobelova nagrada za fiziku

Rainer Weiss, Barry C Barish i Kip S Thorne su proglašeni kao dobitnici Nobelove Nagrade za fiziku za 2017 godinu. Oni su razvili detektor LIGO i uspeli da observiraju gravitacione talase.
Naučnici su počastvovani za njihov rad u razvoju Ligo-a (posebna dizajnirana oprema za observaciju i otkrivanje gravitacionih talasa). "Nagrada ove godine je potresla svet", rekli su Švedskoj Kraljevskoj Akademiji Nauka u Stokholmu.
Od ovih sofisticiranih observatora na Zemlji, naučnici su registrovali gravitacione talase od sudara crnih masivnih rupa nekoliko milijarde svetlosne godine dalje.

Nobel Prize in Physics

Rainer Weiss, Barry C. Barish, and Kip S. Thorne have won the Nobel Prize for physics for decisive contributions to the LIGO detector and the observation of gravitational waves.
Scientists are honored with this prize for the development of LIGO (a specially designed facility for detecting cosmic gravitational waves). "This yeas prize shocked the world" said Royal Swedish Academy of Sciences in Stockholm.
From their sophisticated observatories on Earth, scientists recorded gravitational waves from the collision of a pair of massive black holes some billion light years away.





Çmimi Nobel për mjekësi

Jeffrey C. Hall, Michael Rosbash dhe Michael W. Young kanë fituar Çmimin Nobel në fushën e Mjekësisë, për zbulimet e tyre rreth ritmeve cirka-dike-funksionimin ditor të trupit të njeriut.
Zbulimi i tyre shpjegon se si bimët, kafshët dhe njerëzit përshtatin ritmin e tyre biologjik në mënyrë që të sinkronizohet me lëvizjet e Tokës. Duke përdorur mizat e frutave si model, laureatët e këtij viti zbuluan që një gjen që ata po e analizonin enkodon një proteinë që mblidhet në qeliza gjatë natës dhe pastaj degradohet gjatë ditës. Gjenet dhe proteinat që këta shkencëtarë analizuan kanë një impakt të madh në jetën tonë të përditshme. Duke kuptuar bazat e ritmeve cirkadike kuptojmë më shumë për sjelljet tona, orën e gjumit dhe metabolizmin.

Nobelova nagrada za medicinu

Jeffrey C. Hall, Michael Rosbash i Michael W. Young su dobili Nobelovu Nagradu u oblasti Medicine, za njihovo otkriće oko cirkardialnih ritmova-dnevno funkionisanje ljudskog tela.
Njihovo otkriće objašnjava kako se biljke, životinje i ljudi prilagođavaju u njihvom biološkom ritmu na način da se sinhronizuje sa pomeranjima Zemlje. Upotrebljavajući muve plodova kao model, laureati ove godine otkrili su jedan gen koji su oni analizirali enkodiranje jednog proteina koji se sakuplja u ćelijama tokom noći i potom se degradira tokom dana. Geni i proteini koje su ovi naučnici analizirali imaju jedan veliki uticaj u našem svakodnevnom životu. Shavatajući osnove cirkadialnih ritmova više razumemo o našem ponašanju, vremenu spavanja i metabolizmu.

Nobel Prize in Medicine

Jeffrey C. Hall, Michael Rosbash and Michael W. Young have won Nobel Prize in Medicine for their discoveries of molecular mechanisms controlling the circadian rhythm.
Their discovery explains how plants, animals and humans adapt their biological rhythm in order to synchronize it with Earth movement. By using a fruit fly as a model, they discovered that the gene the scientists were analyzing encodes a protein which gathers in cells at night and disperses during the daytime. The genes and proteins these scientists analyzed have a massive impact on our everyday lives. Understanding the basis of circadian rhythm sheds light on aspects of behavior, sleep cycles, and metabolism.

KEDS ACADEMY 5

KEDS ACADEMY 5

KEDS ACADEMY 5

51 pjesëtarët e rinj të KEDS Academy do të ndjekin pjesën teorike dhe praktike të programit. Në fund ata do të pajisen me certifikata të njohura ndërkombëtare prej Universitetit Boğaziçi nga Stambolli. Këto e bëjnë KEDS Academy programin më të rëndësishëm edukativ në sektorin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave, duke fituar edhe shumë çmime prestigjioze ndërkombëtare.

51 novih učesnika KEDS Academy će pratiti teorijski i praktični deo programa. Na kraju oni će biti opremljeni sa međunarodno priznatim sertifikatima od Univerziteta Boğaziçi iz Istanbula. Ovo čini od KEDS Akademije najvažniji obrazovni program u sektoru Koorporativne Društvene Odgovornosti, dobijajući i mnoga međunarodna priznanja.

51 new members of KEDS Academy will follow the theoretical and practical part of the program. In the end they will be equipped with internationally recognized certificates from Boğaziçi University from Istanbul. This makes KEDS Academy the most important educational program in the Corporate Social Responsibility sector, winning many prestigious international awards.



KEDS Academy po hyn në vitin e pestë, ndërsa tashmë janë rreth 200 të rinj që kanë dalë të përgatitur dhe të aftësuar për tregun e punës, përderisa një pjesë e konsiderueshme e tyre tashmë janë pjesë e KEDS-it.
Këtij projekti edhe këtë vit iu bashkëngjitën edhe 51 pjesëtarë të rinj, të cilët vijnë nga i gjithë vendi me profile të ndryshme. Sikur edhe gjeneratat e mëparshme edhe këta do të ndjekin pjesën teorike dhe praktike të programit. Gjatë kësaj periudhe ata do të avancojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre duke kaluar nëpër disa shkallë të aftësimit.
Si çdo herë tjetër edhe këtë vit janë përzgjedhur më të mirët, me synimin e qartë që të shndërrohen në liderë të së ardhmes përmes programit të lidershipit, si dhe përmes aftësimeve teknike për nxënësit nga shkollat e mesme teknike.

KEDS Academy ulazi u petu godinu, sada imamo oko 200 mladih koji su izašli pripremljeni i osposobljeni za tržište rada, dok jedan priličan deo njih sada su deo KEDS-a.
Ovom projektu i ove godine su se pridružili 51 novih učesnika, koji dolaze iz cele zemlje sa raznim profilima.
Kao i ranije generacije, i oni će pratiti teorisjski i praktični deo programa.
Tokom ovog perioda oni će napredovati i proširiti njihova znanja prelazeći nekoliko stepena osposobljavanja.
Kao i svaki put i ove godine su izabrani najbolji, sa jasnim ciljem da se pretvore u lidere budućnosti preko programa liderširpa kao i tehničkih osposobljavanja za učenike srednjih tehničkih škola.

KEDS Academy is entering the fifth year, while there are already about 200 young people who have been prepared for the labor market, while a considerable part of them are already part of KEDS.
This year 51 new members from all over the country joined this project with. Like previous generations, they will also follow the theoretical and practical part of the program. During this time, they will advance and broaden their knowledge by going through several levels of training.
Like every year, the best ones are selected, with the clear intention to prepare them for future leaders through the leadership program as well as technical training for students from technical secondary schools.

Aftësimi teorik, pos pjesës së menaxhmentit të KEDS-it, bëhet duke u bazuar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit që KEDS ka me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës (MASHT) dhe me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
Pjesë integrale e KEDS Academy edhe këtë vit është Universiteti Boğaziçi nga Stambolli. Ky është ndër universitetet më me renome në botë, përderisa studentët përfitojnë shumë nga profesorët që vijnë nga atje çdo vikend në Prishtinë për të ligjëruar para tyre. Të gjithë kandidatët që kanë përfunduar KEDS Academy janë pajisur edhe me certifikata të njohura ndërkombëtare nga ky universitet.

Teorijsko osposobljavanje, osim dela menadžmenta KEDS-a, vrši se oslanjajući se na sporazumu o saradnji koje KEDS ima sa Ministarstvom Obrazovanja, Nauke i Tehnologije Kosova (MONT) i sa Univerzitetom u Prištini “Hasan Prishtina”.
Integralni deo KEDS Academy i ove godine je Univerzitet Boğaziçi iz Istanbula. Ovo je jedan od univerziteta sa renomeom u svetu, dok studenti dobijaju mnogo od profesora koji dolaze odatle svakog vikenda u Prištini, da bi predavali pred njima.
Svi kandidati koji su završili KEDS Academy su opremljeni i sa međunarodno priznatim sertifikatima od ovog univerziteta.

Theoretical training, apart from the KEDS management, is covered based on the cooperation agreement that KEDS has with the Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo (MEST) and the University of Prishtina “Hasan Prishtina”.
An integral part of KEDS Academy also this year is Boğaziçi University from Istanbul. This is one of the most renowned universities in the world, and students benefit from many professors coming in Prishtina every weekend to give lectures to them.
All candidates who have completed KEDS Academy have also been equipped with internationally recognized certificates from this university.






KEDS Academy është programi më i rëndësishëm edukativ në Kosovë në sektorin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave, duke fituar edhe shumë çmime prestigjioze ndërkombëtare, në mesin e të cilave edhe 4 çmime Stevie Award.
Ky projekt ka nxitur krijimin e disa programeve të ngjashme si në Kosovë, ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Sa i përket edukimit vendor, pikërisht bazuar në KEDS Academy, MASHT ka nisur iniciativën e aftësimit të mëtutjeshëm të nxënësve dhe studentëve përmes institucioneve dhe kompanive anekënd Kosovës.

KEDS Akademija je najvažniji obrazovni program na Kosovu u sektoru Koorporativne Društvene Odgovornosti, dobijajući i mnoge međunarodne prestižne nagrade, među kojima i 4 nagrade Stevie Awards.
Ovaj projekt je inicirao stvaranje i nekoliko sličnih programa na Kosovu, tako i na međunarodnom delu.
Što se tiče domaćeg obrazovanja, upravo zasnovano na KEDS Academy, MONT je započeo inicijativu daljeg osposobljavanja učenika i studenata preko institucija i kompanija širom Kosova.

KEDS Academy is the most important education program in Kosovo in the Corporate Social Responsibility sector, winning many prestigious international awards, among which 4 Stevie Awards.
This project has encouraged the creation of some similar programs in Kosovo and internationally.
As far as local education is concerned, based on KEDS Academy, MEST has launched the initiative of further training of students in institutions and companies throughout Kosovo.


KEDS
KES|CO
KONTAKTI PËR BIZNESE
KEDS / KESCO
Për punë në rrjet
bizline@keds-energy.com
Për pagesa
bizline@kesco-energy.com

PËRFAQËSUESJA MË E RE NË FUTBOLLIN NDËRKOMBËTAR

NAJMLAĐA REPREZENTACIJA U MEĐUNARODNOM FUDBALU

THE KOSOVO NATIONAL FOOTBALL TEAM

Rreth njëzet djem që kanë profesion futbollin përfaqësojnë Republikën e Kosovës në futboll. Kjo përfaqësuese vepron në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës. Kosova është anëtar i UEFA-s dhe FIFA-s që nga maji 2016.

Oko dvadestak momaka kojima je profesija fudbal predstavljaju Republiku Kosova u fudbalu. Ova reprezentacija deluje u sklopu Fudbalske Federacije Kosova. Kosovo je član UEFA i FIFA od maja 2016 godine.

The Kosovo national football team represents Kosovo in international men's football. It operates under the auspices of the Football Federation of Kosovo. They have been a member of UEFA and FIFA since May 2016.

Lojtarët me më së shumti paraqitje



Samir Ujkani është lojtari me më së shumti paraqitje për kombëtaren e Kosovës, deri më tani. Ai u lind më 5 korrik 1988 dhe luan si portier për klubin italian Cremonese. Ujkani më parë përfaqësoi Shqipërinë në U21.

Samir Ujkani je igrač sa najviše utakmica za reprezentaciju Kosova, do sada. On je rođen 5 jula 1988 i brani za italijanski klub Cremonese. Ujkani je ranije predstavljao Albaniju za U21.

Samir Ujkani is the most capped player in the history of Kosovo with 16 caps. Samir Ujkani born 5 July 1988 plays as a goalkeeper for Italian club Cremonese. Ujkani previously represented Albania at youth and full international level .

Igrači sa najviš utakmica



Amir Rrahmani i lindur më 24 shkurt 1994 luan qendërmbrojtës për klubin kroat Dinamo, Zagreb. Ai ka mbi 10 paraqitje për përfaqësuesen e Kosovës.

Amir Rrahmani je rođen 24 februara 1994, igra na poziciji štopera za hrvatski klub Dinamo Zagreb. On ima iznad 10 nastupa za reprezentaciju Kosova.

Amir Rrahmani born 24 February 1994 plays as a centre-back for Croatian club Dinamo Zagreb. He had 11 caps for Kosovo national team.

Most capped players



Fanol Përdedaj luan për 1860 Mynih. Ai u rrit në Gjermani ku përfaqësoi ekipe të ndryshme për të rinj, përpara se të kalonte për të luajtur për Kosovën. Edhe Fanoli ka kaluar 10 paraqitje për Kosovën.

Fanol Përdedaj igra za 1860 Mynih. On je porastao u Nemačkoj gde je igrao za razne ekipe u mlađim kategorijam, pre nego što je prešao da igra za Kosovo. I Fanoli je prešao 10 pojavljivanja za Kosovo.

